



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KRYETARI

Nr. 506 Prot

Shkodër, më 12.01.2021

**KONTRATË QIRAJE**

**E lidhur sot me datën \_\_\_\_\_, 2021, mes palëve:**

1. Bashkia Shkodër, institucion publik me nr NIPT K36813001H, me adrese: Rr. 13 Dhjetori Shkodër, përfaqësuar nga Kryetare Znj. Voltana Ademi, lindur ne Shkoder dhe banuese në Shkodër, madhore e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, që më poshtë do të quhet “Qiradhënësi”.

**Dhe**

2. Subjekti “Bashkim Vllaznimi” shpk – me nr NIPT K86713016K me adrese te zyres qendrore: Rr. Nacionale Shkoder-Grude e Re, nr. pasurie 254/1 ZK 1869, Vorret Publike Stom Golem, Shkoder me administrator Z. Agim Tahiri, lindur ne Shkoder dhe banuese në Shkodër, madhore e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, që më poshtë do të quhet “Qiramarresi”.

**BAZA LIGJORE:**

Ligji nr.7850 dt. 29.07.1994 “Kodi civil i Republikës së Shqipërisë” te ndryshuar.

Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

VKM nr.54 dt. 05.02.2014 “Për percaktimin e kriterëve, te procedurës dhe te menyres se dhenies me qira, enfiteoze apo kontrata te tjera te pasurise shteterore”, të ndryshuar .

*Palët bien dakort sa më poshtë:*

**Neni 1  
Objekti i kontrates**

Objekti i kesaj kontrate eshte dhënia me qira e pasurise se paluajtshme me sipërfaqe 12 m2, nr.pasurie 3/159-N32, ne zonen kadastrale 8594, volum 30, faqe 147, ndodhur ne qytetin Shkoder, pasuri ne pronesi te bashkise Shkoder, bashkelidhur planimetria.

**Neni 2  
Qellimi i kontrates**



Qellimi i kësaj kontrate është dhënia me qira e objektit të percaktuar në nenin 1, për zhvillimin e aktivitetit të tij, zyre shërbimi.

### **Neni 3 Afati i kontratës**

3.1 Kjo kontratë është e vlefshme për 1 (një) vit kalendarik, duke filluar nga data e nënshkrimit saj, me të drejtë rinovimi me kërkesë të qiramarrësit.

### **Neni 4 Pagesa e kontratës**

4.1 Qiramarrësi detyrohet t'i paguaj qiradhenesit detyrimin mujor/vjetor në vlerën prej 2 088 leke/muaj ose 25 056 leke/vit.

4.2 Pagesa e qirase do të jetë mujore/vjetore dhe do të bëhet brenda datës 10 (dhjete) të fillimit të muajit për llogari të institucionit (bashkia Shkodër), në llogarinë e të ardhurave, Dega e Thesarit Shkodër.

### **Neni 5 Të drejtat dhe detyrimet e qiradhenesit:**

5.1 Qiradhenesi (bashkia Shkodër) merr përsipër t'i dorëzojë qiradhenesit sendin sipas përshkrimit në nenin 1, në kohën e caktuar dhe në gjendje që të lejojë përdorimin për të cilën palet janë marrë vesh.

5.2 Qiradhenesi (bashkia Shkodër) është i detyruar të garantojë gezimin e qete të sendit, objekt i kësaj kontrate.

5.3 Qiradhenesi (bashkia Shkodër) nuk përgjigjet për pretendime të tjera që nuk kanë të bëjnë me objektin dhe qëllimin e kontratës.

5.4 Qiradhenesi (bashkia Shkodër) ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës, kur qiramarrësi shkel detyrimet e marra përsipër për dy periudha rresht, duke e njoftuar këtë të fundit 1 (një) muaj më përpara me shkrim.

### **Neni 6 Të drejtat dhe detyrimet e qiramarrësit:**

6.1 Qiramarrësi (Bashkim Vllaznimi shpk), duhet ta përdorë pasurinë objekt i kësaj kontrate vetëm për qëllimin dhe destinacionin e parashikuar në nenin 2.

6.2 Qiramarrësi (Bashkim Vllaznimi shpk), duhet të paguajë detyrimin mujor/vjetor të qirase brenda afatit të percaktuar në nenin 4 (kater) të kontratës.

6.3 Qiramarrësi (Bashkim Vllaznimi shpk), merr përsipër të paguajë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga tatimet, konsumi i energjisë elektrike, konsumi i ujit, gjatë zhvillimit të aktivitetit në ambientin e sipërcituar, që rendojnë mbi pronën e dhënë me qira.

6.4 Qiramarrësi (Bashkim Vllaznimi shpk), nuk ka të drejtë ta shesë, ta japë me qira pronën të treta.

6.5 Qiramarrësi (Bashkim Vllaznimi shpk), merr përsipër ruajtjen e objektit nga ana e tij.

6.6 Qiramarrësi (Bashkim Vllaznimi shpk), nuk ka të drejtë të tjetërsojë objektin.



**Neni 7**  
**Komunikimi**

Çdo komunikim midis paleve do të bëhet me shkrim.

**Neni 8**  
**Njoftimet**

Çdo njoftim, kërkesë apo çdo lloj komunikimi ndërmjet paleve do të bëhet sipas mënyres së përcaktuar në kontratë, njoftimi i paleve do të bëhet me shkrim brenda 15 diteve nga marrja e faktit dhe të problemeve që mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate.

**Neni 9**  
**Forcat madhore**

9.1 Palet përgjigjen për respektimin e kushteve të kësaj kontrate.

9.2 Në rast se ndonjë nga palet e kësaj kontrate pengohet të përmbushë të gjitha ose një nga pjesët e detyrueshme të saj të parashikuara në këtë kontratë si pasoje e Forcës Madhore, kjo pale nuk do të jetë përgjegjëse për mos përmbushjen e detyrimeve të saj gjatë kohezgjatjes së Forcës Madhore dhe për pasojat e shkaktuara dhe që rrjedhin nga Forcat Madhore. Përzullimi i ekzekutimit të kësaj kontrate si pasoje e Forcës Madhore do të kufizohet në periudhën e kohës gjatë së cilës do të vazhdojnë efektet e Forcës Madhore duke u pasqyruar me proces verbal të paleve.

**Neni 10**  
**Zgjidhja e kontratës**

10.1 Me mbarimin e afatit të përcaktuar në nenin 3 (tre) kontrata zgjidhet.

10.2 Kontrata zgjidhet para afatit në rastet kur;

a) palet bien dakort, që mund të zgjidhin kontratën nëpërmjet një njoftimi paraprak me shkrim (një) mujor drejtuar paleve, duke mos shkaktuar dëm, asnjëherë prej paleve.

b) kontrata mund të zgjidhet nga secila prej paleve, me efekt të menjehershëm, në rast të shkeljes së ndonjë prej kushteve të saj ose për shkak të evidentimit të rasteve të forcës madhore.

10.3 Kontrata mund të zgjidhet në mënyrë të njëanshme nga qiradhenesi kur;

a) qiramarresi nuk ka shlyer detyrimin përkatës për dy periudha rresht.

b) qiramarresi demton pronën e marrë me qira.

c) qiramarresi nuk e miremban pronën.

**Neni 11**  
**Dispozita të fundit**

11.1 Për çështjet që nuk trajtohen në kontratën e mesipërme do të zbatohen dispozitat e Kodit Civil ku trajton Kontratën e Qirase.

11.2 Mosmarrëveshjet gjatë zbatimit të kësaj kontrate do të zgjidhen me mirekuptimin mes paleve, në të kundërt palet do të drejtohen gjykatës kompetente.



11.3 Palet kontraktuese rane dakort sa mesiper dhe kjo kontrate u pergatit dhe u nenshkrua në 4 (kater) kopje origjinale.

**Për Bashkinë Shkodër**

**Kryetare**

**Znj. Voltana ADEMI**




**Për Bashkim Vllaznimi shpk**

**Administrator**

**Z.Agim Tahiri**

Agim Tahiri


A blue rectangular official stamp of the company "NDERTIMI SHPK BASHKIM-VLLAZNIM SHKODËR-ALBANIA". The stamp is partially obscured by a handwritten signature in blue ink.



# GEN - PLAN


Sipas percaktimeve te VKM Nr.54 date 05.02.2014

SH 1: 500




Zona Kadastrale 8594  
Indeksi i hartes SH. M-7  
Nr. Pasurise 3/159-N32

SKEMA E VENDOSJES SH. 1:2000



POZICIONI KADASTRAL SH. 1 : 5000



## MIRATOHET KRYETAR I BASHKISË VOLTANA ADEMI



### LEGJENDA

- ZYRA FUNERALE PARRUCE
- ZONA KADASTRALE 8594 SHKODER
- SIPERFAQE NJESIE 12 m2

<b>BASHKIA SHKODER</b> DREJTORIA JURIDIKE / SEKTORI TASETEVE		<b>GRUPI PUNES :</b>	
OBJEKTI: ZYRE FUNERALE		Ing. Lulzim MASHI Adnan Bushati	
Siperfaqe Njesie 12 m2			
EMËRTIMI I FLETËS: ZYRE FUNERALE -PARRUCE		Data:07.01.2019	Shkalla:1:500
		Nr. Fletës: A	